



## POLITIKA E CILËSISË NË KPMM

KPMM bën rregullimin e aktiviteteve në sektorin minerar përmes licencimit dhe inspektimit të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose pasurimit të lëndëve minerale në Republikën e Kosovës.

KPMM siguron kushte të përshtatshme në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore, të aktiviteteve minerare përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe në industrinë minerare, maksimalizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore për të mirën e Republikës së Kosovës.

KPMM ka staf profesionalisht të përgatitur për ofrimin e shërbimeve të nivelit më të lartë. Forca jone buron nga përkushtimi ndaj klientëve, institucioneve, dhe stafit të KPMM.

Qëllimi ynë është ofrimi i shërbimeve cilësore që i përmbushin plotësisht kërkesat e klientëve në përputhshmëri me ligjet në fuqi, sigurimi i një gjendje të qëndrueshme të sektorit minerar, në përputhshmëri me strategjinë minerare.

Nëpërmjet zbatimit të **Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë** sipas standardit **ISO 9001:2008**, do të arrijmë ofrimin e shërbimeve cilësore për përmbushjen e kërkesave të klientëve, institucioneve, punonjësve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Për të arritur qëllimin tonë menaxhmenti dhe punëtorët e KPMM zotohen që të:

- Përmbushin kërkesat, nevojat dhe pritshmërinë e klientëve;
- Veprojnë sipas përgjegjësive të ndara dhe procedurave të përcaktuara;
- Përmbushin në vazhdimësi kërkesat që dalin nga ligjet në fuqi;
- Punojnë në vazhdimësi për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve të punës dhe ngritjen e aftësive të personelit;
- Veprojnë në mënyrë parandaluese me qëllim të evitimit të jokonformiteteve;
- Njohin, zbatojnë dhe rishikojnë politikën e menaxhimit të cilësisë.

Zotimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përvojë dhe motivim të punëtorëve tanë, ngritjen e aftësive të tyre gjithashtu edhe përcjelljen e trendeve zhvillimore.

Prishtinë

29.04.2013

